



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

UDHËZIM

Nr. 09, datë 18.09.2017

**“Për një ndryshim në Udhëzimin e Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 3, datë 27.01.2015
“Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël” të ndryshuar”**

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim “APP”) në mbështetje të nenit 13 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 40, Kreu IV, dhe nenit 83, Kreu XII të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, si dhe pikën 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 918, datë 29.12.2014 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”,

Vendosi:

Në Udhëzimin e APP Nr. 3, datë 27.01.2015 “Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël”, të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

1. Në formularin nr.3 “Ftesa për Ofertë” bashkëlidhur këtij udhëzimi, paragrafi me përmbajtje: “*Operatori ekonomik i renditur i pari, duhet të paraqitet pranë autoritetit kontraktor deri (data dhe ora e përcaktuar nga autoriteti kontraktor)*”,

ndryshohet si më poshtë:

“Operatori ekonomik i renditur i pari, duhet të paraqitet pranë autoritetit kontraktor brenda (orë/ditë të përcaktuar nga autoriteti kontraktor) nga momenti i publikimit në Sistemin e Prokurimit Elektronik të njoftimit të fituesit”.

2. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Elona Hoxhaj

